



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

PROJEKTLIGJI PËR PATENTA

DRAFT LAW ON PATENTS

NACRT ZAKONA ZA PATENTE



<p style="text-align: center;">REPUBLIKA E KOSOVËS KUVENDI</p> <p>Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton</p> <p style="text-align: center;">LIGJIN PËR PATENTA</p> <p>KREU I</p> <p style="text-align: center;">DISPOZITAT E PËRGJITSHME</p> <p style="text-align: center;">Neni 1 Qëllimi</p> <p>Me këtë ligj përcaktohen kushtet për mbrojtjen e shpikjeve me anë të patentës, njohja, vëllimi dhe kohëzgjatja e mbrojtjes, të drejtat ekskluzive, procedurat për regjistrimin, ndryshimin, vazhdimin, zbatimin e të drejtave të Patentës, përfundimi i vlefshmërisë dhe anulimi patentës.</p>	<p style="text-align: center;">THE REPUBLIC OF KOSOVO THE ASSEMBLY</p> <p>Pursuant to article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p> <p>Approves</p> <p style="text-align: center;">LAW ON PATENTS</p> <p>CHAPTER I</p> <p style="text-align: center;">GENERAL PROVISIONS</p> <p style="text-align: center;">Article 1 Aim</p> <p>This Law defines the provisions on invention protection through patents, granted, protection volume and duration, exclusive rights, registration procedures, amendment, extension, enforcement of Patent rights, termination of validity, cancellation, and patent international registration.</p>	<p style="text-align: center;">REPUBLIKA KOSOVO SKUPŠTINA</p> <p>U podršci članu 65 (1) Ustava Republike Kosova,</p> <p>Odobrava</p> <p style="text-align: center;">ZAKON ZA PATENTE</p> <p>GLAVA I</p> <p style="text-align: center;">OPSTE ODREDBE</p> <p style="text-align: center;">Clan 1 Cilj</p> <p>Sa ovim zakonom odredjuju se uslovi za zastitu otkrica putem izuma (patenta), priznanje, opseg i vreme trajanja zastite, postupci za registraciju, izmene, proizuetak, sprovođenje prava izuma (patenta), zavrsetak, vaznosti, ponistenje izuma (patenta) i medjunarodnga registracija izuma (patenta).</p>
--	--	--



Neni 2 Përkufizimet	Article 2 Limitations	Clan 2 Definicije
<p>1. Për qëllim të këtij ligji, shprehjet e përdorura në vijim kanë këto kuptime:</p> <p>1.1. Ministria - nënkupton Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë;</p> <p>1.2. Ministër - nënkupton Ministrin e Tregtisë dhe Industrisë;</p> <p>1.3. Zyra e Pronësisë Industriale (ZPI) - nënkupton Zyrën e Pronësisë Industriale të Republikës së Kosovës në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë;</p> <p>1.4. Konventa e Parisit - nënkupton Konventën e Parisit për mbrojtjen e Pronësisë Industriale të datës 20 mars 1883 të ndryshuar në Bruksel më 14 dhjetor 1900, në Uashington më 2 qershor 1911, në Hagë më 6 nëntor 1925 në Londër më 2 qershor 1934, në Lisbonë më 31 tetor 1958 dhe në Stokholm më 14 korrik 1967, e ndryshuar më 28 shtator 1979;</p> <p>1.5. Unioni i Parisit - nënkupton unionin i formuar nga Konventa e Parisit;</p> <p>1.6. OBT - nënkupton Organizatën Botërore të Tregtisë;</p> <p>1.7. TRIPS - nënkupton marrëveshjen në lidhje me qeshjet tregtare e të drejtave të</p>	<p>1. In order to understand this law, the terms used in the text have the following meaning:</p> <p>1.1. Ministry - means the Ministry of Trade and Industry;</p> <p>1.2. Minister - means the Minister of the Ministry of Trade and Industry;</p> <p>1.3. Office of Industrial Property (OIP) - means the Office of Industrial Property of the Republic of Kosovo within the Ministry of Trade and Industry;</p> <p>1.4. Paris Convention - means the Convention for Protection of Industrial Property of March 20, 1883, as revised at Brussels on December 14, 1900 at Washington on June 2, 1911, at The Hague on November 6, 1925 at London on June 2, 1934, at Lisbon on October 31, 1958, and at Stockholm on July 14, 1967, and as amended on September 28, 1979;</p> <p>1.5. Paris Union - means the Union established by the Paris Convention;</p> <p>1.6. WTO member - means the member of the World Trade Organization;</p> <p>1.7. TRIPS - means an Agreement on Trade-Related Aspects of Intellectual Property</p>	<p>1. Za potrebe ovog zakona, korisceni izrazi u nastavku imaju ova znacjenja:</p> <p>1.1. Ministarstvo - podrazumeva Ministarstvo za Trgovinu i Industriju;</p> <p>1.2. Ministar - podrazumeva Ministra u Ministarstvu za Trgovinu i Industriju;</p> <p>1.3. Kancelarija za Industrijsku Svojину (KIS) - podrazumeva Kancelariju za Industrijsku Svojину u okviru Ministarstva za Trgovinu i Industriju;</p> <p>1.4. Pariska Konvencija - je Konvencija za Zaštitu Industrijskog Vlasništva od 20 Marta 1883, revidirana u Briselu 14 Decembra 1900 u Vašingtonu 2 Juna 1911 u Hagu 6 Novembra 1925 u Londonu 2 Juna 1934, u Lisabonu 31 Oktobra 1958, i u Stokholmu 14 Jula 1967, i sa amandmanima iz 28 Septembra 1979;</p> <p>1.5. Pariska Unija - je unija formirana od strane Pariske Konvencije;</p> <p>1.6. STO - je Svetske Trgovinske Organizacije;</p> <p>1.7. TRIPS - je Sporazum za Aspekte Vezane Za Trgovinu Prava Intelektualne</p>



<p>pronësisë intelektuale (Shtojca 1C e Marrëveshjes e Marruakëshit që formoj Organizatën Botërore të Tregtisë, që u nënshkrua në Marrëveshje të Marokos më 15 Prill të vitit 1994);</p> <p>1.8. Traktati i Bashkëpunimit të Patentës - nënkupton Traktatin e Bashkëpunimit të Patentës i realizuar në Uashington më 19 Qershor 1970, i amendamentuar më 28 Shtator 1979, i modifikuar më 3 Shkurt 1984, dhe më 3 Tetor 2001;</p> <p>1.9. Traktati i Budapestit - nënkupton traktatin e Budapestit për njohjen ndërkombëtare të deponimitit të mikro-organizmave për qëllime të procedurave të patentës, e realizuar në Budapest më 28 Prill 1977, e cila është amendamentuar më 26 Shtator 1980;</p> <p>1.10. Shpikje Bio-teknologjike - nënkupton shpikjet që kanë të bëjnë me një produkt, i cili përbëhet ose përmban material biologjik, apo procesin me anë të të cilit prodhohet, përpunohet ose përdoret materiali biologjik;</p> <p>1.11. Material Biologjik - nënkupton çdo material që përbëhet nga informatat gjenetike dhe që ka aftësi të vetë riprodhimit ose të riprodhohet në një sistem biologjik;</p> <p>1.12. Varietet Bimor - nënkupton çdo</p>	<p>Rights (Annex 1C of the Marrakech Agreement Establishing the World Trade Organization, signed in agreement Morocco on 15 April 1994);</p> <p>1.8. Patent Cooperation Treaty - means the Patent Cooperation Treaty, done at Washington on June 19, 1970, amended on September 28, 1979, modified on February 3, 1984, and October 3, 2001;</p> <p>1.9. Budapest Treaty - means the Budapest Treaty on the International Recognition of the deposit of microorganisms for the Purposes of Patent Procedure, done at Budapest on April 28, 1977, and amended on September 26, 1980;</p> <p>1.10. Bio-technology Invention - inventions that means dealing with a product, which comprises or contains biological material, or process by which the biological material is produced, processed or used;</p> <p>1.11. Biological Material - means any material that consists of genetic information and has the skills of self-production or to get reproduced in a biological system;</p> <p>1.12. Plant Variety - means any plant</p>	<p>Svojine (Aneks 1C Sporazuma u Marakešu za Formiranje Svetske Trgovinske Organizacije, potpisane u Marakešu, Maroko, 15 Aprila 1994);</p> <p>1.8. Traktat Saradnje za Patente - je Traktat Saradnje za Patente, pripremljen u Vašingtonu 19 Juna 1970, dopunjen 28 Septembra 1979, modifikovan 3 Februara 1984, i 3 Oktobra 2001;</p> <p>1.9. Traktat iz Budimpešta - je Traktat iz Budimpešte za Međunarodno Priznavanje eponovanja mikro-organizama za Potrebe Patentskih Procedura, pripremljen u Budimpešti 28 Aprila 1977, i dopunjen 26 Septembra 1980;</p> <p>1.10. Bio-tehnološki Izum - podrazumeva izume koji su vezani za jedan proizvod, koji je sastavljen iz, ili sadrži biološki materijal, ili proces putem kojeg se proizvodi, obrađuje ili koristi biološki materijal me;</p> <p>1.11. Biološki Materijal - podrazumeva svaki materijal koji se sastoji iz genetskih informacija i koji ima sposobnost samostalno re-proizvodnje ili da se re-proizvede u jedan biološki;</p> <p>1.12. Biljni Varietet - podrazumeva svaku</p>
---	--	---



<p>bimë të grupuar nën një lloj të vetëm botanik të klasifikimit më të ulët të njohur i cili grupim, pavarësisht nëse plotësohen tërësisht kushtet për pranimin e varietetit bimor mund të:</p> <p>1.12.1. Përcaktohet me shprehjen e karakteristikave që rezultojnë nga gjenotipi i caktuar apo kombinim i gjenotipeve;</p> <p>1.12.2. Dallohet nga çdo grupim tjetër i bimëve duke shprehur së paku njërin prej karakteristikave të lartpërmendura, dhe</p> <p>1.12.3. Vlerësohet si njësi në lidhje me përshtatshmërinë për tu shumëfishuar në mënyrë të pandryshueshme.</p> <p>1.13. Proces për prodhimin e bimëve ose kafshëve - nënkupton procesin i cili në thelb është biologjik, nëse përbëhet tërësisht nga fenomeni natyror si kryqëzimi ose seleksionimi.</p> <p>1.14. Proces Mikrobiologjik - nënkupton çdo proces që përfshinë, kryhet ose është rezultat i materialit mikrobiologjik.</p> <p style="text-align: center;">Neni 3</p> <p>1. Personat fizik dhe juridik që nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës apo nuk kanë seli të regjistruar të biznesit në</p>	<p>grouped under a single type of botanical classification less known, grouping which, whether if fully met the conditions for plant acceptance, can be</p> <p>1.12.1. Determined by the expression of characteristics which results from genotype set or combination of genotypes;</p> <p>1.12.2. Distinguished from any other plant grouping by expressing at least one of the above mentioned characteristics, and</p> <p>1.12.3. Considered as a unit in connection with the suitability to be multiplied in a constant manner.</p> <p>1.13. The process for manufacturing plants or animals - means the process is essentially biological, if composed entirely of natural phenomena such as crossing or selection.</p> <p>1.14. Microbiological process - means any process involving is performed or is the result of microbiological material.</p> <p style="text-align: center;">Article 3</p> <p>1. Natural and legal persons who are not citizens of the Republic of Kosovo or who have not registered based business in</p>	<p>biljku grupisanu pod jednom jedinstvenom botaničkom vrstom najniže znane klasifikacije, koja grupa, nezavisno ako u potpunosti ispunjava uslove za prihvatanje biljnog varijeteta, može da:</p> <p>1.12.1. Se odredi izražavanjem karakteristika koje rezultuju iz određenog genotipa ili kombinacije genotipova;</p> <p>1.12.2. Se razlikuje iz svake druge grupacije biljaka izražavajući najmanje jednu od gore-navedenih karakteristika, i</p> <p>1.12.3. Procenjuje se kao jedinica u vezi sa podudarnošću za razmnožavanjem na nezmenjujući način.</p> <p>1.13. Proces za proizvodnju biljaka ili životinja - podrazumeva proces koji je u srži biološki, ako se u potpunosti sastoji iz prirodnog fenomena kao što je ukrštanje ili selekcija.</p> <p>1.14. Mikrobiološki Proces- podrazumeva svaki proces koji uključuje, izvršava se, ili je rezultat mikrobiološkog materijala.</p> <p style="text-align: center;">Član 3</p> <p>1. Pravna i fizička lica koji nisu državljani Republike Kosovo ili nemaju registrovano sedište preduzetništva na Kosovu, uživaju</p>
---	--	---



<p>Kosovë, gëzojnë të drejta të barabarta në mbrojtjen e shpikjes me patentë me personat fizik dhe juridik që kanë vendqëndrim të përhershëm në Kosovë.</p> <p>2. Të huajt mund të ushtrojnë të drejtat sipas këtij ligji, në procedurat para Zyrës për Pronësi Industriale, vetëm përmes përfaqësuesve të autorizuar sipas nenit 128 të këtij ligji.</p> <p>KREU II</p> <p>ZYRA PËR PRONËSI INDUSTRIALE</p> <p>Neni 4 Organizimi</p> <p>1. Zyra për Pronësi Industriale e Republikës së Kosovës, është organ i pavarur administrativ shtetërorë, e themeluar në bazë të ligjit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë - në tekstin e mëtejshëm Zyra dhe është përgjegjëse për mbrojtjen ligjore të shpikjeve, markave tregtare, dizajneve industriale, emërtimeve të origjinës, treguesëve gjeografik dhe topografive të qarqeve të integruara, si dhe çështjet e tjera që dalin nga</p>	<p>Kosovo, have equal rights in the invention of patent protection same as natural and legal persons who have permanent residence in Kosovo.</p> <p>2. Foreigners may practice the rights under this law, in proceedings in front of Industrial Property Office only through authorized representatives under section 128 of this law.</p> <p>CHAPTER II</p> <p>INDUSTRIAL PROPERTY OFFICE</p> <p>Article 4 Organization</p> <p>1. Industrial Property Office of the Republic of Kosovo, is the state administrative body, established by law in the Ministry of Trade and Industry - hereinafter the Office and is responsible for the legal protection of inventions, trademarks, industrial designs, names of origins, geographical indications and topographies of integrated circuits and other issues arising from international agreements to which the signatories is the Republic of Kosovo. The office is</p>	<p>podjednaka prava za zaštitu izuma patentom sa pravnim i fizičkim licima koji imaju stalno prebivalište na Kosovu.</p> <p>2. Strani državljani mogu da traže prava na osnovu ovog zakona, u procedurama ispred Kancelarije za Industrijsko Vlasništvo, samo preko autorizovanih predstavnika na osnovu člana 128 ovog zakona.</p> <p>GLAVA II</p> <p>KANCELARIJA ZA INDUSTRIJSKU SVOJINU</p> <p>Član 4 Organizacija</p> <p>1. Kancelarija za Industrijsku Svojinu Republike Kosova, je administrativno drzavno telo, i odgovorno je za za zakonsku zastitu o krica, trgovackih marki, industrijskih dizajna, imenovanje porekla, geografske i topografske pokazatelje za integrisana kola, kao i druga pitanja koja proizlaze iz medjunarodnih sporazuma cija je potpsinica i Republika Kosova. Kancelarija je nezavisna u svojim aktivnostima.</p>
--	---	---



<p>marrëveshjet ndërkombëtare nënshkruese e të cilave është Republika e Kosovës. Zyra është e pavarur në aktivitetet e saja.</p> <p>2. Organizimi dhe funksionimi i Zyres rregullohet me akt nenligjor.</p> <p style="text-align: center;">Neni 5 Përgjegjësitë e Zyrës</p> <p>1. Zyra në veçanti është përgjegjëse për:</p> <p>1.1. Kryerjen e procedurave në lidhje me dhënien e patentave, çertifikatave suplementare të mbrojtjes për shpikje, regjistrimin e markave tregtare, dizajnëve industriale, topografit e qarqeve të integruara, emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografik;</p> <p>1.2. Mbajtjen dhe mirëmbajtjen e regjistrave për përfaqësuesit e objekteve të pronës industriale;</p> <p>1.3. Publikimin e një gazete zyrtare, të titulluar Buletini Zyrtar për Pronësinë Industriale në Kosovë, që përmban të dhëna për aplikimin dhe të drejtat e dhëna për pronësinë industriale;</p> <p>1.4. Ofrimin e shërbimeve informuese lidhur me objektet e pronësisë industriale;</p>	<p>independent in its activities.</p> <p>2. Organization and functioning of the Office is regulated by a bylaw.</p> <p style="text-align: center;">Article 5 Responsibilities of the Office</p> <p>1. The Office shall be in particular responsible for:</p> <p>1.1. Performing the procedures concerning the granting patents, supplementary protection certificates for inventions, registration of the trademarks, industrial designs, topographies of integrated circuits, designations of origin and geographical indications;</p> <p>1.2. Keeping and maintaining registers of the objects of the industrial property representatives;</p> <p>1.3. Publication of an official gazette, entitled Official Bulletin for Industrial Property in Kosovo, which provides the information on the application and the rights granted to the Industrial Property;</p> <p>1.4. Providing the services of information concerning Industrial Property objects;</p>	<p>2. Organizovanje i funkcionisanje kancelarije uredjuje se podzakonskim aktom.</p> <p style="text-align: center;">Član 5 Odgovornosti Kancelarije</p> <p>1. Kancelarija posebno je odgovorna za:</p> <p>1.1. Obavljanje postupaka koji su vezani sa izdavanjem suplementarnih dozvola i sertifikata za otkrice, registraciju trgovačkih marki, industrijskih dizajna, topografije za integrisana kola, nazive za porekla i geografske pokazatelje;</p> <p>1.2. Cuvanje i održavanje registara za prava industrijske svojine za predstavnike objekata industrijske svojine;</p> <p>1.3. Objavljivanje jednog službenog lista, nazvanog Službeni Glasnik za Industrijsku svojinu na Kosovu, koji sadrži podatke za apliciranje i prava za industrijsku svojinu;</p> <p>1.4. Nudjenje informativnih usluga vezani za objekte industrijske svojine;</p>
--	---	---



<p>1.5. Për organizimin e testimit për përfaqësues të autorizuar në fushën e të drejtave të pronësisë industriale;</p> <p>1.6. Përgatitjen e propozimeve për miratimin e akteve ligjore dhe nenligjore, inicimin e ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e të drejtave të pronësisë industriale;</p> <p>1.7. Përfaqësimin e Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare për pronën industriale.</p> <p>1.8. Realizimin e detyrave tjera që janë nën kompetenc të saj.</p> <p style="text-align: center;">Neni 6 Shqyrtimi i vendimeve të marra nga Zyra</p> <p>1. Kundër vendimeve të Zyrës lejohet ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.</p> <p>2. Ankesa i drejtohet komisionit që obligohet, të vendosë dhe ta njoftojë palën.</p> <p>3. Komisioni i shqyrtimit të ankesave formohet me vendim të Ministrit.</p>	<p>1.5. Conducting examinations for representatives in the field of Industrial Property rights;</p> <p>1.6. Preparing the proposals for adoption of legal acts and bylaws and initiating ratification of international agreements in the field of industrial property rights;</p> <p>1.7. Representing the Republic of Kosovo in international organizations for industrial property.</p> <p>1.8. Performing any other tasks falling under its competence.</p> <p style="text-align: center;">Article 6 Review of the decision made by the office</p> <p>1. Against office decision is allowed to file an appeal within the time limit of fifty days from the day when the decision was received.</p> <p>2. The appeal shall be addressed to the commission, to decide and inform the party.</p> <p>3. Commission for review of the appeals is established by the decision of the Minister.</p>	<p>1.5. Vestacenje za predstavnike iz oblasti prava industrijske svojine/realizacija vestacenja ovlascenih predstavnika u oblasti prava industrijske svojine;</p> <p>1.6. Priprema predloga za usvajanje podzakonskih i ostalih akata i pokretanje retafikacije medjunarodnih sporazuma u oblasti prava industrijske svojine;</p> <p>1.7. Predstavljanje Kosova u stranim, regionalnim i medjunarodnim organizacijama za industrijsku svojinu;</p> <p>1.8. Realizacija ostalih zadataka koji su po njenom nadleznosci.</p> <p style="text-align: center;">Član 6 Razmatranje odluke donete od strane Kancelarije</p> <p>1. Protiv odluke Kancelarije Je dozvoljeno žalba u roku od petnaist (15) dana od dana prijema odluke.</p> <p>2. Žalba se adresuje komisiji koja se od prijema žalbe, da odluči i obavestiti stranku.</p> <p>3. Komisija za razmatranje žalbi se osnova odlukom Ministra</p>
--	---	---



<p>4. Kundër vendimit të komisionit mund të parashtrahet padi në Gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh.</p> <p>5. Kompetencat, mandati dhe puna e komisionit rregullohen me akt nënligjor</p> <p>KREU III</p> <p>LËNDA E MBROJTJES ME PATENTË</p> <p>Neni 7 Shpikja e Patentueshme</p> <p>1. Patenta jepet për çdo shpikje, në çdo fushë të teknologjisë, që përbën risi, hap shpikës dhe që është e zbatueshme në industri.</p> <p>2. Shpikje sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk konsiderohen:</p> <p>2.1. Zbulimet, teoritë shkencore dhe metodat matematikore; 2.2. Krijimet estetike; 2.3. Skemat, rregullat dhe metodat për kryerjen e akteve mendore, lojërat ose realizimi i veprimtarive të biznesit, dhe</p>	<p>4. Against decisions of the commission a calim may be lodged in the competent court within the time limit of thirty days.</p> <p>5. Competences mandate and work of the commission shall be regulated by bylaws.</p> <p>CHAPTER III</p> <p>SUBJECT MATTER OF THE PATENT PROTECTION</p> <p>Article 7 Patentable Invention</p> <p>1. A patent shall be granted for any invention, in any field of technology that is new, involves an inventive step and is susceptible in the industry.</p> <p>2. The following in particular shall not be regarded as inventions within the meaning of paragraph 1 of this article:</p> <p>2.1. Discoveries, scientific theories and mathematical methods; 2.2. Aesthetic creations; 2.3. Schemes, rules and methods for performing mental acts, playing games or doing business, and programs for computers;</p>	<p>4. Protiv odluke komisiJe može se podneti tužba nadležnom sudu u roku od 30 dana.</p> <p>5. Nadležnosti, mandat i rad komisiJe se regulise sa podzakonskim aktom.</p> <p>GLAVA III</p> <p>PREDMET ZASTITE SA PATENTTE</p> <p>Član 7 Otkrica Patentiranja</p> <p>1. Patent za izadaje za otkrice, u savkoj oblasti tehnologije, koja sadrzi novinu, otkrivni korak i koji je se moze sprovesti u industriji.</p> <p>2. Otkrice prema stavu 1 ovog clana ne smatraju se:</p> <p>2.1.Otkrica, naucne teorije i matematski nacini; 2.2. Estetska stvaralastva; 2.3. Sheme, pravila i metode za obavljanje misaonih cinova, igre ili realizacija delatnosti za biznise i programe za</p>
--	--	--



<p>programet për kompjuterë;2.4. Prezantimi i informatës.</p> <p>3. Objektet ose veprimtaritë e cekura në paragrafin 2 nënparagrafi 2.3 të këtij neni përjashtohen nga patentueshmëria deri në atë masë në të cilin aplikimi për patentë ose patenta lidhet me vetë këto objekte apo me këto veprimtari.</p> <p style="text-align: center;">Neni 8 Patentueshmëria e shpikjeve Bioteknologjike</p> <p>1.Patenta jepet për shpikje, nëse plotësohen kërkesat e cekura në nenit 7 paragrafin 1 e të cilat kanë të bëjnë me:</p> <p>1.1.Produktin që përbëhet ose përmban material biologjik;</p> <p>1.2. Procesin me anë të të cilit prodhohet, përpunohet ose përdoret materiali biologjik;</p> <p>1.3. Materialin biologjik, i cili është i izoluar nga mjedisi natyror ose prodhohet me anë të një procesi teknik, edhe në qoftë se ka ndodhë më parë në natyrë;</p> <p>1.4. Varietetet bimore ose shtazore, nëse realizueshmëria teknike e shpikjes nuk kufizohet në një varietet të caktuar bimor</p>	<p>2.4. Presentations of information.</p> <p>3. Subject matters or activities referred to in paragraph 2 subparagraph 2.3 of this article shall be excluded from patentability to the extent to which the application for a patent or patent related to those subject matters or activities as such.</p> <p style="text-align: center;">Article 8 Patentability of biotechnological Inventions</p> <p>1. If the requirements referred to in paragraph 1 of article 7 of this Law are fulfilled, a patent shall be granted for an invention which concerns:</p> <p>1.1. A product consisting of or containing biological material;</p> <p>1.2. A process by means of which the biological material is produced, processed or used;</p> <p>1.3. A biological material which is isolated from its natural environment or produced by means of a technical process, even if it previously occurred in nature;</p> <p>1.4. Plants or animal variety if the technical feasibility of the invention is not confined to a particular plant or animal variety.</p>	<p>kompjutere;</p> <p>2.4. Predstavljanje informacije;</p> <p>3. Objekti ili navedena dela u stavu 2 podstava 2.3 ovog clana iskljucuju se od patentiranja, u onoj meri gde je aplikacija za patente ili patent sam se veze sa ovim objektima ili sa ovim delatnostima.</p> <p style="text-align: center;">Član 8 Patentiranost bio - tehnoloskih Otkrica</p> <p>1. Patent sa izdaje za otkrice, ako se ispunjavaju zahtevi navedeni u clanu 7 stav 1 a koja se ticu:</p> <p>1.1. Proizvod koji se sastoji ili sadrzi bioloski materijal;</p> <p>1.2. Proces pomocu koga se proizvodi, preradjuje se ili koristi bioloski materijal;</p> <p>1.3. Bioloski materijal, koji je izolovan od prirodne okoline ili se proizvodi pomocu jednog tehnickog procesa, i ako se ranije dogodio u prirodi;</p> <p>1.4. Biljne ili zivotinjske varijacije, ako se tehnicka realizacija otkrica ne ogranicava u jednu odredjenu biljnu ili zivotinjsku</p>
--	---	--



<p>ose shtazor.</p> <p style="text-align: center;">Neni 9 Përrjashtimi nga Patentueshmëria</p> <p>1. Patenta nuk jepet për:</p> <p>1.1. Shpikjet, shfrytëzimi komercial i të cilave mund të jetë në kundërshtim me rendin publik ose moralin; një përdorim i tillë mund të vlerësohet se bie në kundërshtim me to, edhe nëse nuk ndalohej me ligj;</p> <p>1.2. Varietet bimore ose shtazore, apo proceset thelbësore biologjike për prodhimin e bimëve ose shtazëve; kjo dispozitë nuk aplikohet në proceset mikrobiologjike ose produktet e tyre;</p> <p>1.3. Metodat për trajtimin e trupit të njeriut ose kafshëve me anë të kirurgjisë ose terapisë dhe metodave diagnostifikuese, të ushtruara në trupin e njeriut ose kafshëve; kjo dispozitë nuk aplikohet në produktet, në veçanti në substancat ose përbërjen, që përdoren në këto metoda.</p> <p>1.4. Substancat, që përftohen nëpërmjet transformimeve të brendshme nukleare për qëllime ushtarake.</p> <p>2. Sipas neneparagrafit 1.1 të këtij neni</p>	<p style="text-align: center;">Article 9 Exclusion from Patentability</p> <p>1. A patent shall not be granted in respect of:</p> <p>1.1. Inventions the commercial exploitation of which would be contrary to "ordre public" or morality; such exploitation shall not be deemed to be so contrary merely because it is prohibited by law or regulation;</p> <p>1.2. Plants or animal variety, or biologic essential procedures for producing of plants or animal; this provision shall not apply to the micro-biologic procedure or their product;</p> <p>1.3. Methods for treatment of the human or animal body by surgery or therapy and diagnostic methods practised on the human or animal body; this provision shall not apply to products, in particular substances or compositions, for use in any of these methods;</p> <p>1.4. Substance that are result of internal nuclear transformations for the army.</p> <p>2. Under paragraph 1.1 of this article, a</p>	<p>varijaciju.</p> <p style="text-align: center;">Član 9 Isključivanje od Patentiranosti</p> <p>1. Patent se ne izadaje za:</p> <p>1.1. Otkrica, čija komercijalna upotreba može da bude u suprotnosti sa javnim redom i moralom; jedan takva upotreba može da se smatra da je u suprotnosti sa njima, i ako se ne zabranjuje sa zakonom.</p> <p>1.2. Biljne ili životinjske varijacije, ili bitni biološki procesi za proizvodnju bilja ili životinja; ova odredba se ne aplikuje u mikrobiološkim procesima ili njihovim proizvodima;</p> <p>1.3. Metode za tretiranje tela čoveka ili životinja putem kirurgije ili terapije ili dijagnostičnih načina, koja se vrše na telu čoveka ili životinja; ova odredba se ne aplikuje u proizvodima, a posebno u sastojcima ili sastavima, koji se koriste u ovim načinima.</p> <p>1.4. Sastojci koji se dobivaju putem unutrašnje nuklearne transformacije za vojne ciljeve.</p> <p>2. Prema stavu 1.1 ovog člana patent se ne</p>
---	--	--



<p>patenta nuk do të jepet për shpikjet bioteknologjike, të cilat në veçanti kanë të bëjnë me:</p> <p>2.1. Proceset e klonimit të qenieve njerëzore;</p> <p>2.2. Proceset për modifikimin e identiteti gjenetik të linjës gjenetike (embrionale) të qenieve njerëzore;</p> <p>2.3. Përdorimin e embrioneve njerëzore për qëllime industriale ose komerciale; dhe</p> <p>2.4. Proceset për modifikimin gjenetik të kafshëve, të cilat mund t'ju shkaktojnë vuajtje kafshëve pa pasur ndonjë dobi të rëndësishme mjekësore për njerëzimin apo për kafshët, si dhe kafshët që janë rezultat i proceseve të tilla.</p> <p style="text-align: center;">Neni 10 Trupi i njeriut dhe pjesët përbërëse të Tij</p> <p>1. Trupi i njeriut, në faza të ndryshme të formimit dhe zhvillimit të tij dhe zbulimi i thjeshtë i njëres prej pjesëve përbërëse të tij, përfshirë sekuençën ose një pjesë të sekuençës së gjenit, nuk përbënë shpikje të patentueshme.</p> <p>2. Elementi i izoluar nga trupi i njeriut,</p>	<p>patent shall not be granted in respect of biotechnological inventions which, in particular, concern the following:</p> <p>2.1. Processes for cloning human beings;</p> <p>2.2. Processes for modifying the germ line genetic identity of human beings;</p> <p>2.3. Uses of human embryos for industrial or commercial purposes; and</p> <p>2.4. Processes for modifying the genetic identity of animals which are likely to cause them suffering without any substantial medical benefit to man or animal, and also animals resulting from such processes.</p> <p style="text-align: center;">Article 10 The human body and its Elements</p> <p>1. The human body, at the various stages of its formation and development, and the simple discovery of one of its elements, including the sequence or partial sequence of a gene cannot constitute patentable inventions.</p> <p>2. An element isolated from the human body</p>	<p>ce izdavati sa biotehnoloska otkrica, koja se posebno ticu:</p> <p>2.1. Procesi kloniranja ljudsko tela;</p> <p>2.2. Procesi za modifikaciju genetskog identiteta genetske linije (embrionske) ljudskog tela;</p> <p>2.3. Upotreba ljudskih embriona za industrisjke ili komercijalne ciljeve; i</p> <p>2.4. Procesi za genetsku modifikaciju zivotinja, koji mogu da stvore patnje zivotinjima bez neke znacajne medicinske koristi za ljude ili zivotinje, kao i zivotinje koje su rezultat takvih procesa.</p> <p style="text-align: center;">Član 10 Ljudsko telo i njeni sastavni Delovi</p> <p>1. Ljudsko telo, u raznim fazama formiranja i njenog razvoja i osnovno otkrice jednog od njenog sasatavnog dela, ukljucujuci sekvencu ili jedan deo sekvence gena, ne cine patentirano otkrice.</p> <p>2. Izolovani elemenat od ljudskog tela, ili</p>
--	--	--



<p>ose që është prodhuar ndryshe me anë të procesit teknik, përfshirë sekuencën ose një pjesë të sekuencës së gjenit, mund të përbëj shpikje të patentueshme, edhe pse struktura e atij elementi është identike me atë të elementit natyror.</p> <p>3. Zbatimi industrial i sekuences apo pjesës së sekuences së gjenit, me rastin e aplikimit për patentë duhet të zbulohet ashtu siç është dorëzuar fillimisht.</p> <p style="text-align: center;">Neni 11 Risja</p> <p>1. Shpikja konsiderohet e re, nëse nuk bën pjesë në njohuritë e mëparshme.</p> <p>2. Njohuria e mëparshme përbëhet prej gjithë asaj që i është vënë në dispozicion publikut në nivel botëror, me anë të përshkrimit të shkruar ose gojor, përdorimit, ose në ndonjë mënyrë tjetër, para datës së dorëzimit të aplikacion për patentë.</p> <p>3. Njohuri të mëparshme përbëjnë edhe përmbajtja e aplikacionit për patentë kombëtare ashtu siç është dorëzuar, si dhe pas pranimit të Republikës së Kosovës në</p>	<p>or otherwise produced by means of a technical process, including the sequence or partial sequence of a gene, may constitute a patentable invention, even if the structure of that element is identical to that of a natural element.</p> <p>3. The industrial application of a sequence or a partial sequence of a gene must be disclosed in the patent application as originally filed.</p> <p style="text-align: center;">Article 11 Novelty</p> <p>1. An invention shall be considered to be new if it does not form part of the state of the art.</p> <p>2. The state of the art shall comprise everything made available to the public on the world level by means of a written or oral description, by use, or in any other way, prior to the filing date of the patent application.</p> <p>3. Additionally, the content of national patent applications as filed and, after the accession of the Republic of Kosovo to the Patent Cooperation Treaty and the European</p>	<p>ako je frugacije proizvoden putem tehnickog procesa, ukljucujuci sekvencu ili deo sekvence gena, moze da sadrzi patentirano otkrice, iako je struktura tog elementa identicna sa onim od prirodnog elementa.</p> <p>3. Industrijsko sprovođenje sekvence ili deo sekvence gena, u slucaju aplikacije za patent treba da se otkrije tako kao sto je predata na pocetku.</p> <p style="text-align: center;">Član 11 Novina</p> <p>1. Otkrice se smatra novim, ako ne ucestvuje u ranijim saznanjima.</p> <p>2. Ranije saznanje sastoji se od svega onogo sto je dato na javno raspolaganje na svetskom nivou, putem pismenog ili usmenog opisa, upotrebe, ili na neki drugi nacin, pre datuma predaje aplikacije za patent.</p> <p>3. Ranija saznanja cine i sadrzaj aplikacije za nacionalne patente onako kako je predata, i posle prijema Republike Kosova u Traktatu Saradnje za Patente i Evropsku</p>
---	--	---



<p>Traktatin e Bashkëpunimit për Patenta dhe Konventën Evropiane të Patentave, përmbajtja e të gjitha aplikacioneve për patentë ndërkombëtare dhe Evropiane me efekt për Kosovën, datat e dorëzimit të të cilave janë të më hershme se sa data e aplikacionit, të cekur në paragrafin 2 të këtij nenin, dhe të cilat janë botuar në këtë datë ose pas kësaj date.</p> <p>4. Paragrafët 2 dhe 3 nuk përjashtojnë patentueshmërinë - mbrojtjen me patentë e substancës ose përbërjes, e cila bën pjesë në njohuritë e mëparshme për përdorim në metodat e cekura në nenin 9 paragrafi 1.3 të këtij Ligji, me kusht që përdorimi i saj në metoda të tilla nuk bën pjesë në njohuritë e mëparshme.</p> <p>5. Paragrafët 2 dhe 3 nuk përjashtojnë patentueshmërinë e asnjë substance ose përbërjeje të cekur në paragrafin 4 për përdorim specifik në metodën e cekur në nenin 9 paragrafi 1.3 të këtij Ligji, me kusht që përdorimi i tillë nuk është pjesë e njohurive të mëparshme ekzistuese.</p>	<p>Patent Convention, the content of all international and European patent applications with the effect for the Republic of Kosovo, the filing dates of which are earlier than the date of application referred to in paragraph 2 of this article, and which were published on or after that date, shall be considered as comprised in the state of the art.</p> <p>4. Paragraphs 2 and 3 shall not exclude the patentability of any substance or composition, comprised in the state of the art, for use in a method referred to in paragraph 1.3 of article 9 of this Law, provided that its use for any such method does not form part of the state of the art.</p> <p>5. Paragraphs 2 and 3 shall also not exclude the patentability of any substance or composition referred to in paragraph 4 for any specific use in a method referred to in paragraph 1.3 of article 9 of this Law, provided that such use does not form part of the state of the art.</p>	<p>Konvenciju Patenata, sadrzaj svih aplikacija za Evropske i medjunarodne patente sa efektom i na Kosovu, datumi predaje od kojih su ranije od datuma aplikacije, istaknutog u stavu 2 ovog clana, i koji su objavljeni na ovaj datum ili posle ovog datuma.</p> <p>4. Stavovi 1 i 2 ne iskljucuju patentiranost - zastitu sa patentima sastojka ili sastava, koja ucestvuje u ranijim saznanjima za upotrebu u navednim nacinima u clanu 9 stav 1 3 ovog Zakona, pod uslovom da njena upotreba u takvim nacinim ne ucestvuje u ranijim saznanjima.</p> <p>5. Stavovi 2 i 3 ne iskljucuju patentiranost nijednog sastojka ili sastava nevedenih u stavu 4 za specificnu upotrebu na navedeni nacin u clanu 9 stav 1.3 ovog Zakona, pod uslovom da takva upotreba nije deo ranijih postojećih saznanja.</p>
--	--	---



Neni 12 Shpalesja e shpikjes pa pasoja të Dëmshme	Article 12 Non-prejudicial invention Disclosures	Član 12 Obelodanjivanje otkrica bez stetnih Posledica
<p>1. Zbulimi i shpikjes sipas nenit 11 të këtij Ligji nuk do të merret në konsideratë, nëse kjo ka ndodhur jo më parë se gjashtë muaj para dorëzimit të aplikimit për patentë dhe në qoftë se ka ndodhur ose si pasojë e:</p> <p>1.1. Abuzimit të dukshëm në lidhje me kërkuesit ose paraardhësit e tij ligjor, ose faktit që aplikuesi apo paraardhësit e tij ligjor ka zbuluar shpikjen në një ekspozitë ndërkombëtare zyrtare, ose zyrtarisht të njohur, sipas kushteve të parapara të Konventës për ekspozita ndërkombëtare, me kusht që aplikuesi në momentin e paraqitjes së aplikacionit për patentë tregon, se shpikja është zbuluar në këtë mënyrë, dhe jo më vonë se 4 muajve nga data e paraqitjes së kërkesës, dorëzon një çertifikatë përkatëse për këtë qëllim.</p>	<p>1. For the application of article 11 of this Law, a disclosure of the invention shall not be taken into consideration if it occurred no earlier than six months preceding the filing of the patent application and if it was due to, or in consequence of:</p> <p>1.1. An evident abuse in relation to the applicant or his legal predecessor, or the fact that the applicant or his legal predecessor has displayed the invention at an official, or officially recognised, international exhibition falling within the terms of the Convention on international exhibitions, provided that the applicant indicates in the patent application, at the time of its filing, that the invention has been so displayed, and not later than 4 months as from the filing date of the application, submits a corresponding certificate to that effect.</p>	<p>1. Otkrivanje izuma prema članu 11 ovog Zakona neće se uzimati u obzir, ako se ovo dogodilo ne više od šest meseci pre predaje aplikacije za patente i ako je učinjeno kao posledica:</p> <p>1.1. Vidljive upotrebe u vezi sa podnosiocem ili njegovog zakonskog prethodnika, ili činjenice koje aplikanti ili njegovi zakonski prethodnici otkrio izum na jednoj međunarodnoj izložbi, ili službeno priznatu, prema predviđenim uslovima Konvencije za međunarodne izložbe, pod uslovom da podnosilac aplikacije u trenutku predaje aplikacije za patent dokaze, da je izum otkriven na ovaj način, i ne kasnije od 4 meseca od datuma predaje zahteva, predaje jedan odgovarajući izvod za ovaj cilj.</p>
Neni 13 Shkalla e Risisë <p>1. Shpikja konsiderohet se ka shkallë të risisë nëse nuk është e njohur për personin me njohuri në atë fushë, duke marrë</p>	Article 13 Inventive Step <p>1. An invention shall be considered as involving an inventive step if, having regard to the state of the art, it is not obvious to a</p>	Član 13 Stepen Novine <p>1. Otkrice se smatra da ima jedan stepen novine ako otkrice nije poznato za kvalifikovano lice sa znanjima u toj</p>



<p>parasysh njohuritë e mëparshme.</p> <p>2. Nëse vendoset se shpikja përmban shkallën e risisë, përmbajtja e aplikacionit të cekur në nenin 11 paragrafi 3 të këtij ligji, nuk merret parasysh.</p> <p style="text-align: center;">Neni 14 Zbatueshmëria në Industri</p> <p>Shpikja është e zbatueshme në industri nëse lënda e saj mund të prodhohet ose të përdoret në çdo lloj industrie, përfshirë edhe bujqësinë.</p> <p style="text-align: center;">KREU IV SHPIKJET SEKRETE</p> <p style="text-align: center;">Neni 15 Shpikja sekrete dhe Autoriteti Kompetent</p> <p>1. Shpikja e shpikur nga një shtetas i Republikës së Kosovës mund të konsiderohet shpikje sekrete, në qoftë se ajo ka të bëjë me interesat shtetërore si mbrojtjen kombëtare apo sigurinë e shtetit.</p>	<p>person skilled in the art.</p> <p>2. In deciding whether an invention involves an inventive step, the content of the applications referred to in paragraph 3 of article 11 of this Law shall not be taken into consideration.</p> <p style="text-align: center;">Article 14 Industrial Applicability</p> <p>An invention shall be industrially applicable if its subject matter can be manufactured or used in any kind of industry, including agriculture.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER IV SECRET INVENTIONS</p> <p style="text-align: center;">Article 15 Secret Invention and the Competent Authority</p> <p>1. An invention made by a national of the Republic of Kosovo may be considered to be a secret invention, if it concerns state interests as national defence or the security of the State.</p>	<p>oblasti, uzimajući u obzir ranija saznanja.</p> <p>2. Ako se odluci da otkrice ne cini stepen novine, sadrazaj navedene aplikacije u clanu 11 stav 3 ovog zakona, ne uzima se u obzir.</p> <p style="text-align: center;">Član 14 Sprovodnost u Industriji</p> <p>Otkrice je sprovodljivo u industriji ako njen predmet moze da se proizvede u svaku vrstu industrije, ukljucujuci i poljoprivredu.</p> <p style="text-align: center;">GLAVA IV TAJNA OTKRICA</p> <p style="text-align: center;">Član 15 Tajno otkrice i nadležni Autoritet</p> <p>1. Otkriveno otkrice od strane jednog drzavljana Kosova moze da smatra tajno otkrice, ako je ono vezano za nacionalnu zastitu ili bezbednost drzave.</p>
---	--	--



<p>2. Autoriteti kompetent për shpikjet sekrete është Këshilli i Sigurisë së Kosovës (ne tekstin e metejme Autoriteti Kompetent) i cili me akte të veqanta përcakton kriteret e veqanta dhe procedurën për shpikje sekrete.</p> <p>3. Shpikja sekrete përbënë sekret shtetëror.</p> <p style="text-align: center;">Neni 16 Procedura e aplikimit për shpikje Sekrete</p> <p>1. Aplikimet që kanë të bëjnë me shpikjet e parapara sipas nenit 15 paragrafit 1 të këtij ligji, i dorëzohen Autoritetit kompetent nga Zyra.</p> <p>2. Nëse Zyra gjatë ekzaminimit të aplikacionit për patentë, konsideron se aplikacioni ka të bëjë me shpikje sekrete, sipas kriterëve të veqanta të përcaktuara nga Autoriteti kompetent sipas nenit 15 paragrafi 2 ajo e përcjell atë tek Autoriteti kompetent.</p> <p>3. Aplikacioni i përcjellur tek Autoriteti kompetent, do të ruaj datën e dorëzimit të caktuar nga Zyra.</p>	<p>2. The competent authority for secret inventions shall be the Security Council of the Republic of Kosovo (hereinafter Competent Authority), that by special acts determines particular criterias and procedures for secret inventions.</p> <p>3. A secret invention shall constitute a State secret.</p> <p style="text-align: center;">Article 16 Procedure in respect of secret patent Application</p> <p>1. The Applications in regard to inventions set as in paragraph 1 of article 15 of this law, shall be forwarded to the Competent Authority by the Office.</p> <p>2. If the Office establishes, when examining the patent application that it concerns a secret invention, according to the specific criteria defined by the Competent Authority set in paragraph 2 of article 15, the application its shall be forwarded at the Competent Authority.</p> <p>3. The application forwarded at the Competent Authority, shall be saved the submitting date defined by the Office.</p>	<p>2. Nadležni Autoritet za nacionalnu odbranu (u daljnjem tekstu Nadlezi Autoritet) odredjuje posebne kriterijume i postupke na osnovu kojih otkrice se odredjuje kao “tajno otkrice”.</p> <p>3. Tajno otkrice sadrzi drzavnu tajnu.</p> <p style="text-align: center;">Član 16 Postupak aplikacije za tajna Otkrica</p> <p>1. Aplikacije koje su vezane sa predvidjenim otkricima prema clanu 15 stava 1 ovog zakona, predaju se Nadleznom Autoritetu.</p> <p>2. Ako Kanecelarija tokom vestacenja aplikacije za patente, smatar da apikacija ima veze sa tajnim otkricima, prema posebnim kriterijumima odredjenih od Nadleznog Autoriteta prema clanu 15 stav 2 ona to predaje kod Nadleznog Autoriteta.</p> <p>3. Aplikacija predata kod Nadleznog Autoriteta, sacuvace datum predaje odredjenog od Kancelarije.</p>
--	---	---



<p>4. Nëse Autoriteti kompetent me rastin e shqyrtimit të aplikacionit vlerëson se shpikja nuk përbën sekret, aplikacioni kthehet në Zyre.</p> <p>5. Nëse autoriteti kompetent, vlerëson se është fjala për shpikje sekrete, ai lëshon vendim dhe e regjistron atë në regjistrin e patentave për shpikje sekrete që mbahet nga ai.</p> <p>6. Nëse autoriteti kompetent mendon se shpikja nuk është sekrete, procedura do të kryhet nga Zyra dhe në përputhje me këtë ligj.</p> <p style="text-align: center;">Neni 17 Shfrytëzimi dhe Kompensimi</p> <p>1. Autoriteti kompetent ka të drejtën ekskluzive për të përdorur shpikjen sekrete.</p> <p>2. Shpikësi ka të drejtë për kompensim për shpikjen sekrete të mbrojtur, pavarësisht se a është përdorur shpikja apo jo.</p> <p>3. Shuma e kompensimit e cekur në paragrafin 2 do të përcaktohet në përpjesëtim me vlerën e tregut të shpikjes.</p>	<p>4. If the Competent Authority, when examining the patent application that is not considered to be secret, the application shall be returned to the Office.</p> <p>5. If the competent authority decides that a secret invention is concerned, it shall issue a decision to that effect and shall enter it in the register of patents for secret inventions kept by it.</p> <p>6. If the authority competent for national defence considers that the invention is not secret, the procedure shall be carried out by the Office and in accordance with this Law.</p> <p style="text-align: center;">Article 17 Exploitation and Compensation</p> <p>1. The authority competent for national defence or in internal affairs shall have the exclusive right to use a secret invention.</p> <p>2. The inventor shall be entitled to a one-time compensation for the protected secret invention, regardless of whether or not the invention is used.</p> <p>3. The amount of the compensation referred to in paragraph 2 shall be determined in proportion to the market value of the</p>	<p>4. Ako Nadležni Autoritet prilikom razmatranja aplikacije proceni da otkrice ne cini tajnu, aplikacija vraca se u Kancelariji.</p> <p>5. Ako nadležni autoritet, proceni da se radi o tajnom otkricu, on donosi resenje i isto registruje u registar za patente za tajna otkrica koje se cuva od njega.</p> <p>6. Ako nadležni autoritet smatra da otkrice nije tajno, postupak ce završiti od strane Kancelarije i u skladu sa ovim zakonom.</p> <p style="text-align: center;">Član 17 Koriscenje i Nadoknada</p> <p>1. Nadležni autoritet ima izvršno pravo da koristi tajno otkrice.</p> <p>2. Otkrivac ima pravo na nadoknadu za tajno otkrice, nezavisno da li je korisceno otkrice ili ne.</p> <p>3. Iznos nadoknade naveden u stavu 2 Odredjivace se u podeli sa trzisnom vrednoscu otkrica.</p>
---	--	---



<p>4. Në rast të mos arritjes së marrëveshjes për kompensim, shpikësi, mund të kërkojë nga gjykata kompetente përcaktimin e shumës së kompensimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 18 Procedura pas dhënies së patentës për shpikje Sekrete</p> <p>1. Nëse autoriteti kompetent për mbrojtjen kombëtare përcakton se shpikja nuk është më sekret, ai do të përcjell tek Zyra dosjen që ka të bëjë me shpikjen.</p> <p>2. Zyra me kërkesën e aplikuesit, fillon ose përfundon procedurën e dhënies së patentës për shpikjen e cila nuk është më sekrete.</p> <p style="text-align: center;">Neni 19 Mbrojtja jashtë Vendit</p> <p>Personat fizik dhe juridik vendor, mund të kërkojnë mbrojtjen e shpikjes sekrete jashtë vendit vetëm me autorizim të autoritetit kompetent për siguri kombëtare.</p>	<p>invention.</p> <p>4. In case an agreement is not reached, the holder of the patent right, may request the competent court to determine the amount of the compensation.</p> <p style="text-align: center;">Article 18 Procedure after the Grant of a Patent for a secret Invention</p> <p>1. If the authority competent for national defence establishes that the invention has ceased to be secret, it shall forward the file concerning the invention to the Office.</p> <p>2. The Office shall enter such patent in the appropriate Register, and shall, at the request of the applicant, initiate or resume the patent granting proceedings.</p> <p style="text-align: center;">Article 19 Protection Abroad</p> <p>Domestic legal and natural persons may seek protection of secret inventions abroad only with the authorization of the authority competent in national security.</p>	<p>4. U slucaju da se ne postize sporazum za nadoknadu, otkrivac moze zatraziti o nadleznog suda odredjivanje iznosa nadoknade.</p> <p style="text-align: center;">Član 18 Procedura posle davanja patente za zaštitu patente poverljivih Pronalazaka</p> <p>1. Ako nadlezni autoritet za nacionalnu zastitu odredjuje da otkrice nije vise tajna, on ce propratiti kod Kancelarije dosije koja se tice otkrica.</p> <p>2. Kancelarija na zahtev podnosioca aplikacije, pocinje ili završava postupak izdavanja patenta za otkrice koja vise nije tajna.</p> <p style="text-align: center;">Član 19 Zastita van Zemlje</p> <p>Fizicka i pravna domaca lica, mogu da zatrazе zastitu tajnog otkrica van zemlje samo sa ovlascenjem nadleznog autoriteta za nacionalnu bezbednost.</p>
---	---	--



KREU V	CHAPTER V	GLAVA V
E DREJTA PËR PATENTË	RIGHT TO OBTAIN A PATENT	PRAVO NA PATENTE
Neni 20 E drejta për Patentë	Article 20 Right to a Patent	Član 20 Pravo na Patent
